

Gjirokastrë , më ____ . ____ . 2023

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, – SHËRBIME”, Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj.

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësinë e Koordinimit Gjirokastrë FSHU sh.a”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79713000-5, 66515000-3 Shebim me roje private, per sigurimin ne rast demi ose humbje.

VLERA E FONDIT LIMIT: 23,199,725 (njëzet e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

AFATI: 36 (tridhjetë e gjashtë) nga lidhja e kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a, Gjirokastrë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Transport dhe shoqërim i vlerave monetare”, nënkategoria I.3.B.
2. Çertifikatë e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat sigurisë fizike, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, date 05.03.2018, nënkategoria I.3.B.
3. Çertifikatë e Drejtuesit Teknik të Shoqërisë e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat sigurisë fizike, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, date 05.03.2018, nënkategoria I.3.B.
4. Çertifikatë e “Punonjësit të Shërbimit”, kategoria I.3.B, për jo me pak se **12** punonjës shërbimi (6 të çertifikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër dhe 6 të çertifikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë) lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshaur), në nenin 14/b të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Numri i punonjësve është kërkuar në përputhje me Udhëzimin nr. 130 datë 05.03.2018 pika C “Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese”, kategoria A: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë deri në 10.000.000 lekë realizohet meb)jo më pak se 2 punonjës shërbimi të SHPSF-së.... Nisur nga fakti që shërbimi do të ofrohet në tre KNK me vendndodhje të ndryshme si dhe duke marrë në konsideratë 2 punonjës shërbimi për shoqërim, kërkohen 6 punonjës shërbimi në tërësi.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në se OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të

paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Argumentimi: Në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin E Taksave Vendore” (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së parashikuar.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes të deklaruara në tatime, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit/marrëveshjes kuadër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik të ketë Qendër Kontrolli në Qarkun Gjirokastrë dhe në Qarkun Vlorë, fakt i cili provohet me paraqitjen e Aktit të Miratimit të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, të

jetë lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe Vlorë, në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin Privat të sigurisë fizike" dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika D. Qendra e Kontrollit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm, ku në pikën 5 parashikohet: Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve. ***Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.***

2.3.3 Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për "Radiokomunikimin" konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit operatori ekonomik të jetë licencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në pikën D. Qendra e Kontrollit, të Kreut VII, Uniformat, mjetet, pajisjet e shërbimit, dokumenti I identifikimit të punonjësve të SHPSF-SË, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm dhe në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë vërtetim (performance) nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe Vlorë, lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave, në të cilën pasqyrohet informacioni i mëposhtëm:

- a. Për numrin e punonjësve të shërbimit të çertifikuar për jo më pak se 6 punonjës shërbimi, nënkategoria I.3.B, per secilin qark.
- b. Disponimi i 3 mjeteve të blinduara në secilin qark.
- c. Armë brezi (B1) 3 copë, (B4) 3 copë për secilin qark.
- d. Që ka 6 jelek anti plumb, 6 radiokomunikimi, 6 hekura lidhës, 6 shkopinj gome (vërtetuar kjo nga një vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastër/Vlorë ose nëpërmjet paraqitjes së faturën tatimore për blerjen e tyre) .

- e. Operatori Ekonomik të mos ketë shkelje të konstatuara dhe masë administrative të marrë ndaj tij nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe Vlorë nga data 1 janar 2021 deri ne daten e lëshimit të vërtetimit.
- f. Vërtetimi të përmbajë vlerësim përmbledhës për performancën e Operatorit Ekonomik.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarreveshje.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht KREU I, Procedurat për licencim, certifikim dhe ricertifikim të subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, germa A. Të përgjithshme, pika 11. Certifikata e punonjësit të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike jepet sipas nënkategorisë së licencës dhe miratimi i saj është kompetencë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, ku ka vendbanimin punonjësi i shërbimit, bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim (KSHKC), të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit duke marrë si reference daten e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara elektronikisht nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **14 punonjës të siguruar në muaj**, 12 punonjës shërbimi që do tu paraqiten certifikatat I.3.B si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-s.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht referuar në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme, ***duhen më shumë se një shoqërues për automjet, duke përfshirë titullarin e shoqërisë, drejtuesin teknik dhe stafin e qendrave të kontrollit, disponimi i një numri prej 14 punonjësish të siguruar është numri minimal i kërkuar, për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.***

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë të **paktën 3 (tre) mjete të blinduara** me norme blindimi minimalisht BR3 (sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018) në emër të shoqërisë ose me qera për transportin e vlerave monetare **për secilin qark**. Mjetet e blinduara duhet të jenë të pajisura me:

- Autorizim të posaçëm vjetor nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për përdorim të çdo mjeti të blinduar (të vlefshëm), ku të jenë përcaktuar emri i shoqërisë, të dhënat e mjetit dhe afati i vlefshmërisë.
- Çertifikatë pronësie.
- Leje qarkullimi nga Drejtoria e Transportit Rrugor për çdo mjet.
- Leje drejtimi të përdoruesit të mjetit të blinduar.
- Siguracion të vlefshëm.
- Vërtetim për taksat e paguara.
- Marrja me qira ose huapërdorja e automjeteve të mësipërme, do të pranohet nëse kontrata/t e qiramarrjes / huapërdorjes janë të lidhura para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të kontratës për këtë shërbim, të shoqëruara me dokumentacion (çertifikatë pronësie, leje + qarkullimi, siguracion dhe akt kolaudimi të vlefshëm). Në rast të mjeteve në përdorim apo me qera, në autorizimin përkatës të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të jetë shënuar emri i përdoruesit apo qeramarrësit. (Referuar Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm Nr. 1362/2 Prot datë 29.05.2006 dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me Nr.5495 Prot dt.31.05.2006 “Për karakteristikat konstruktive dhe funksionale të mjeteve të blinduara”.

Disponimi i mjeteve të blinduara në fazën e ofertimit të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomike të Formularit Përmbledhës të Deklarimit sipas Shtojcës Nr.9 të DST-së ku të pasqyrohet disponimi i mjeteve të kërkuara të blinduara me të gjithë dokumentacionin e cituar më lart. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin e mësipërm i cili duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar (sipas kërkesave të nenit 82 të LPP-se).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Keto automjete janë të nevojshme për transportimin e vlerave monetare, pa të cilat do të ishte i pamundur transporti i këtyre vlerave. Janë kërkuar 3 mjete të blinduara për secilin Qark duke marrë në konsideratë nr. KNK-ve, distancat e largësive dhe oraret e transportit.

Operatorët ekonomik duhet të përcaktojnë çmimin e ofertes duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (si psh: pagë bazë, shtesë page turni II, sigurimet shoqerore, si dhe kosto të tjera te kryerjes se sherbimit). Ofertat qe nuk respektojne kerkesat ligjore do te konsiderohen nenkoston ligjore dhe do te skualifikohen

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sqarim: Çdo kriter i parashikuar ne nenin 26, pika 2 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, permbushet nga Operoret Ekonomik nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Ne baze te nenit 26 ,pika 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” (e ndryshuar) , “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike bazuar në legjislacionin në fuqi për ruajtjen e vlerave monetare.

Fondi limit është llogaritur nga komisioni për llogaritjen e vlerës së prokurimit, ngritur me urdhërin nr.281 prot, datë 28.04.2023, materializuar në procesverbalin me nr.281/1 prot, dt.08.11.2023.

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk

ekziston një mënyrë e njafueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-së duhet të jetë i përbërë nga punonjës të certifikuar në Nenkategorinë 1.3.B sipas parashikimeve të Kreut VI pika C për shoqërimin e vlerave monetare. Keta punonjës duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, uniforme dhe dokument identifikimi sic parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 "Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe Udhezimin Nr. 130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm botuar në Fletoren Zyrtare datë 09.03.2018 .
- Ky Grup duhet të shoqërojë vlerat monetare që i janë besuar dhe të sigurojë jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është Shoqërimi i sigurtë i punonjësve (arketareve) nga Filialet e FSHU sh.a drejt filialeve të Bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU sh.a.
- Punonjësi i OSHEE sh.a (arketari/rja) duhet të shoqërohet nga roje të armatosura.
- Për transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet të pajisë punonjësit e shërbimit me arme sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.75 /2014 "Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Shoqërimi duhet të kryhet nga një mjet i Operatorit Ekonomik. Mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare që të kryejë shoqërimin e vlerave monetare.
- Shoqërimi i vlerave monetare do të kryhet një ose dy here në ditë sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar dhe në zbatim të plote të instruksioneve të personave përgjegjës të OSHEE sh.a, me grafik shërbimi përkatesisht nga dita e Hënë - Shtunë.
- Koha maksimale e procesit të shoqërimit të vlerave monetare do të jetë 2 orë. **Ofruesi i Shërbimit SHPSF duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme :**
- Të jetë i certifikuar nga autoritetet kompetente për ushtrimin e funksionit.
- Të reflektojë një sjellje korrekte dhe të respektueshme.
- Gjatë gjithë kohës së shërbimit punonjësi i Shoqërisë SHPSF duhet të respektojë rregullat e brendshme të OSHEE Group sh.a.
- Të kërkojë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të Objektivit.
- Punonjësi i Shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe të veprojë gjithmone në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga FSHU sh.a.

- Punonjesit e Shoqerise SHPRSF qe kryejne shoqerimin e vlerave monetare duhet te jene te pajisur me armatim sipas ligjeve ne fuqi dhe ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr.130 datë 05.03.2018 “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” si dhe me mjete speciale per perballimin e situatave nga sulme te mundshme me qellim grabitjen e vlerave monetare (Radio , Shkop gome , hekura lidhes etj).
- Shoqëria private per te siguruar shoqerimin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesi te detyrës duhet te vere në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit; armatim personal sipas ligjit per armet, jelek antiplumb, hekura lidhes, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
- Të gjithë punonjësit e shërbimit “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014 dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, publikuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018.
- Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike “, punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e sherbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjesit e sherbimit duhet te zbatojne Nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike“ ku percaktohet qarte se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”*.
- Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do te përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqerimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet te përcaktoje rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe te përpiloje plandislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtje për situata emergjente. Ai do te jete përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do te siguroje bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

- Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL.
- Qendra e Kontrollit duhet të realizojë monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimi në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe :

a) nëpërmjet telefonit celular (GSM);

b) nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID);

c) (radio).

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Qyteti	Arka	Turni i Parë	Turni i Dytë
1	Gjirokastrë	Arka KNK	PO	PO
2	Tepelenë	Arka KNK	PO	JO
3	Përmet	Arka KNK	PO	JO
4	Sarandë	Arka KNK	PO	PO
5	Delvinë	Arka KNK	PO	PO
6	Ksamil	Arka KNK	PO	PO

Shërbimi të ofrohet 26 ditë në muaj

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Detyrat:

- Shoqërimi i sigurve i punonjesve (arketareve) nga filialet e KNK-ve drejt filialeve të bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU sh.a.
 - Punonjësi i FSHU sh.a (arketari/rja) duhet të shoqërohet nga 2(dy) roje të armatosur.
 - Rojat duhet të jene të pajisura me armatim sipas ligjeve në fuqi.
 - Shoqërimi duhet të kryhet nga një mjet i kompanisë së shoqërimit, mjete duhet të jete i loguar,ne gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare të kryeje shoqërimin e vlerave monetare.
 - Shoqërimi i vlerave monetare do të kryhet njëherë në ditë (KNK Tepelenë, KNK Përmet) dhe dy herë në ditë (KNK Gjirokastrë, KNK Sarandë, KNK Delvinë, KNK Ksamil), sipas instruksioneve të personave përgjegjës të OSHEE sh.a dhe sipas grafikut të përcaktuar në tabelat e mëposhtëme.
 - Koha maksimale e procesit të shoqërimit të vlerave monetare do të jetë 2 orë .
 - Koha orare e shoqërimit të vlerave monetare do të jetë :
 - Turni i parë nga ora 15:00-17:00
 - Turni i dytë nga ora 20:00-22:00
 - Grupet e Shoqërimit do të paraqiten pranë KNK/Arkë (sipas Grafikut të mëposhtëm) në orën 15^{oo} gjatë Turni I dhe 20^{oo} Turni II. Kohëzgjatja e Shërbimit përfshijnë :
 1. paraqitjen e Grupeve të Shoqërimit në orarin e përcaktuar,
 2. pritja e perfundimit nga arketalet e procesit perpunimit te veprimeve te arkës,
 3. shoqërimi i arketaleve nga KNK deri ne mjetin e blinduar,
 4. shoqërim te vlerave monetare nga KNK/Arka me destinacion Deget e Bankës se nivelit te dyte,
 5. shoqërimi i arketaleve nga mjete i blinduar në degën e Bankës së nivelit të dytë dhe deri në përfundimin e procesit të depozitimit të vlerave monetare nga arketalet në Bank.
 6. Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” të publikuar ne fletoren zyrtare date 08.08.2014, Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, dhe në aktet e tjera nënligjore.
- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**

- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 29.12.2023 , ora 11:00 , vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al.**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.